VENDIM
Nr. 202, datë 10.8.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "EZ-5 ENERGY" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 MW, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE NR. 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU I FIERIT

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "a", dhe nenit 38, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pika 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1439/1prot., datë 8.8.2022, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit",

konstatoi se:

- Shoqëria "EZ-5 Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387 prot., datë 28.7.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c".

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c" dhe "g".

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germat "a" dhe "d".

- Dokumentacioni teknik për centralin fotovoltaik – neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, germat "a", "b", "c" dhe "d" dhe pika 4.4.4, germa "b".

Dokumentacioni i munguar apo i plotësuar pjesërisht është si vijon:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor

neni 9, pika 2:

- **germa "d"**

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Durrës, për vetë shoqërinë.

- **germa "e"**

Shoqëria duhet të depozitojë informacion nëse është bërë efektive organigrama sikurse parashikuar, si dhe të paraqesë licencën e drejtuesit teknik elektrik.

- **germa "f"**

Në referencë të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 417, datë 15.6.2022, "Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit, nga shoqëria "EZ-5 Energy" shpk", shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën përkatëse me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe informacion/dokumentacion në lidhe me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik.

Dokumentacioni teknik për centralin fotovoltaik

neni 9, pika 4.4.2

Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat mbi gjatësinë e linjës.

Leje nga institucione të tjera

neni 9, pika 4.4.5.

- **germa "b"**

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen/VNM përkatëse për centralin fotovoltaik 10 MW të shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k.

- Gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë në formatin origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin, dokumentacionin sipas përcaktimeve të germave "b" dhe "c", pika 3, të nenit 9; germave "a", "b" dhe "c", të pikës 4.4.4, të nenit 9; si dhe germës "a", të pikës 4.4.5, të nenit 9.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a" të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se në Studimin e Fizibilitetit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik 10 MW, të shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k. jetëgjatësia e burimit rezulton 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 MW, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti